



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe nenin 2, paragrafi (1), pika 29) dhe nenin 64, paragrafi (3) nga Ligji për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/10, 90/09, 67/10 dhe 26/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/14)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12 dhe 50/13), në pikën 6), nënpika 22), fjalët: "**Si kërkesë e siguruar** konsiderohet kërkesa në shumë-bruto (pa u zvogëluar shuma e amortizimit të akumuluar, korrigimi i vlerës, gjegjësisht rezerva e veçantë, primin ose zbritjen dhe efektet nga ndryshimi i vlerës objektive) që është e siguruar me instrumente për mbrojtjen e kredisë nga kreu VI.2 të këtij vendimi." ndryshohen si vijon:

"Si **kërkesë e siguruar** konsiderohet kërkesa që është siguruar me instrumente për mbrojtjen e kredisë nga kreu VI.2 të këtij vendimi, pa u zvogëluar vlera kontabiliste e tij për shumën e amortizimit të akumuluar, korrigimi i vlerës, gjegjësisht rezerva e veçantë, primin ose zbritjen dhe efektet nga ndryshimi i vlerës objektive."

2. Në pikën 38 paragrafi (4) nënparagrafi 2), pika zëvendësohet me presje dhe pas nënparagrafit (2) shtohet nënparagraf i ri (3) që vijon:

"- detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të garancive të performancës, gjegjësisht garancitë me të cilat nuk garantohet plotësimi i detyrimit kreditor të caktuar nga debitori, siç janë: garancitë për ekzekutim të mirë, garancitë për kthim të avansit, garancitë për pjesëmarrje të tenderit dhe të gjitha garancitë me të cilat garantohet ekzekutim i caktuar."

Në paragrafin (5), nënparagrafi (2) ndryshohet dhe thotë:

"-detyrimet e ndërmarra jashtë bilancit në bazë të garancioneve doganore, garancitë për pagesë të tatimit dhe garancitë tjera të ngjashme;"

3. Në pikën 39), pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2) që thotë:

"Me përjashtim të kreut VI.1 të këtij vendimi, banka mund të zbatojë ponder të rrezikut nga 0% të kërkesave nga fondet që janë themeluar (në tërësi) prej një ose më shumë qeveri qendrore, bankat multilaterale të zhvillimit ose institucione publike me trajtim të qeverisë qendrore në të cilat, në pajtim me vendimin, zbatohet ponder i rrezikut prej 0%, me ç'rast burim i vetëm i financimit të këtyre fondeve janë mjetet e paguara nga këto institucione në formë të pjesëve (non leveraged)."

4. Në pikën 58), paragrafi (2), pas fjalës: "i përcaktuar" shtohet fjala:

“afatgjatë”.

5. Në pikën 101), nënpika 2a), pas fjalëve: “trajtim të qeverisë qendrore” shtohen fjalët: “edhe personat nga pika 39 paragrafi 2 të këtij vendimi”.

6. Në pikën 165), paragrafi (1), fjalët: “tabela nr. 8” zëvendësohen me fjalët: “tabela nr. 18”.

7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

V nr. 02-15/IV-1/2014
30 prill 2014
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov